

V E N D I M
Nr. 30/1, datë 14.11.2000

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO KOMBËTARE FM PRIVATE “TOP ALBANIA”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “TOP ALBANIA” SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.091998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit njëzëri:

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “TOP ALBANIA” sh.a. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator kombëtar radio FM privat në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë FM për një periudhë 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.